



Republika Kosovo 31.03.2026 Opština Ranilug
Republika e Kosoves Komuna e Ranillugut
Republic of Kosovo Municipality of Ranilug

Duke u mbështetur në nenin 12, paragrafi 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, („Gazeta Zyrtare e RK” nr. 28/2008), nenet 5 dhe 10 të Rregullores për dhënien e subvencioneve nr. 02-128/2024, planin vjetor të punës së departamentit për arsimin, kulturën, sportin, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale nr. 04-1-004/2026, dhe planin vjetor të mbështetjes financiare publike për organizatat joqeveritare nr. 04-1-008/2026, nenin 15, paragrafi 15.1 të Statutit të Komunës së Ranillugut nr. 02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut në seancën e tretë të rregullt të mbajtur më 31.03.2026 ka miratuar:

V E N D I M

PËR SUBVENCIONIMIN E MANIFESTIMEVE KULTURO-SPORTIVE DHE VIZITAVE STUDIMORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RANILLUGUT

1.

Propozimi i propozuar kaloi shqyrtimin kryesor në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut, e mbajtur më 31.03.2026, ku është aprovuar dhe miratuar njëzëri.

2.

Me këtë vendim miratohet Plani i aktiviteteve në fushën e kulturës dhe sportit.

Plani i aktiviteteve në fushën e kulturës

Janë planifikuar këto aktivitete kulturore:

- Ndërmarrësia e grave
- Manifestime kulturo-sportive:
 - në Ropotov e Madhe – “Festat e Vidovdanit”
 - në Ranillug – “Morava derdhet në këngë”
 - në Korminjan – “Festat e Zonjës së Madhe (Velikogospojina)”
- Koncerti vjetor i SHKA “Simonida”
- “Festivali i Teatrit” – Korminjan
- “Kolonja e Arteve Pamore” – Ropotov e Madhe

Plani i aktiviteteve në fushën e sportit

Planifikohen aktivitete sportive në të gjitha vendbanimet e Komunës dhe në kuadër të manifestimeve që mbahen:

- në Ropotov e Madhe – “Festat e Vidovdanit”,
- në Ranillug – “Morava derdhet në këngë”,
- në Korminjan – “Festat e Zonjës së Madhe”,

- në fshatin Tomanc-Pançell – “Turneu i Petrovdanit”,
- në fshatin Domorovc – “Turneu i Shën Ilisë”, (Svetoiliski turnir)
- në fshatin Rajanovc “Turneu e Shën Gjergjit ”

aktivitetet si në vijim:

- Turne në futboll të vogël
- Ndeshje futbollli
- Turne tenisi
- Turne në pingpong
- Gara shumëdisiplinore
- Basketboll
- Volejball
- Qitje
- Vrap krosi në dy kategori (meshkuj, femra)

Është e nevojshme që manifestimet kulturo-sportive të subvencionohen dhe të përfshihen në kalendarin komunal të subvencionimit, sipas renditjes për secilën manifestim kulturo-sportiv dhe një vizitë studimore, si më poshtë:

Maj

- Manifestimi kulturo-sportiv “Morava derdhet në këngë” (Vice-Ljube-Zhelje-Gjolle), mbahet në Ranillug në periudhën 1–5 maj
Mjetet e nevojshme: 3.500 €
- “Turneu e Shën Gjergjit ” – Rajanovc, në periudhën 3–6 maj
Mjetet e nevojshme: 1.500 €

Qershor

- Festat e Vidovdanit – mbahen në Ropotov e Madhe në periudhën 19–28 qershor
Mjetet e nevojshme: 3.500 €
- “Festivali i Teatrit” – Korminjan
Mjetet e nevojshme: 1.500 €
- “Kolonia e Arteve Pamore” – Ropotov e Madhe
Mjetet e nevojshme: 1.500 €

Korrik

- Turneu i futbollit për Petrovdan – mbahet në fshatin Tomanc-Pançell në periudhën 8–12 korrik
Mjetet e nevojshme: 1.500 €

Gusht

- Turneu i futbollit për Shën Ilinë – mbahet në fshatin Domorovc në periudhën 1–3 gusht
Mjetet e nevojshme: 1.500 €
- Manifestimi kulturo-sportiv “Ditët e Zonjës së Madhe” – mbahet në fshatin Korminjan në periudhën 25–28 gusht
Mjetet e nevojshme: 1.500 €

Tetor

- Grup joformal i grave – vizitë studimore
Mjetet e nevojshme: 2.500 €

Dhjetor

- Koncerti vjetor i SHKA “Simonida”
Mjetet e nevojshme: 1.000 €

3.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 02-020/2026 i datës 31.01.2026 për subvencionimin e manifestimeve kulturo-sportive dhe vizitave studimore në territorin e Komunës së Ranillugut.

4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria e Financave dhe Zyra e Kryetares

5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Data: 31.03.2026

Ranillug



Kryetar i KK së Ranillugut

Ivan Krstiq
Ivan Krstiq